



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0028867-1/26 dt. 26.05.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 5-të

Koha: 26.05.2026 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami,

Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot kam thirrur mbledhjen e pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Valon Brahimi: Në mbledhje mungojnë Kryetari dhe Nënkyetari e njëri është dashtë me qenë në mbledhje, e kam ngritur edhe më herët çështjen e rastit në Këqiu ku është kallur shtëpia dhe e kam diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, ata i kanë marrë disa hapa dhe me vetiniciativë e kanë vu një kulm, ka qenë mirë që Drejtoria e Emergjencave me i ndihmuar në çështjen e merçmimit që me i bërë funksionale ato dy dhoma, personi që jeton aty e ka gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale. Në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të formohet një komision për ta shqyrtuar nga afër gjendjen e tij, por deri më tani nuk është formuar asnjë komision dhe sot në mbledhje mungojnë Kryetari dhe Nënkyetari për trajtimin e këtij problemi. Drejtorët duhet me ja përcjellë këtë kërkesë Kryetarit sepse është afër Festa e Bajramit dhe shtëpia e tij ende nuk është e gatshme për banim.

Në vazhdim Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raport mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026
3. Raport i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025

Rendi i ditës u miratua unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 1

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Igballe Islami: Përshëndetje të gjithëve. Fillimisht, dua ta përgëzoj Sekretarinë për punën e tyre, në procesverbal janë të faktuara disa të pavërteta që kanë dalë pikërisht nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa. Në të gjithë këtu përfaqësojmë qytetarët por edhe subjekte politike që na kanë deleguar në këtë komitet. Përveç materialit të mbledhjes që e kemi pranuar me datë 08.04, më datën 20 janë shtuar edhe katër pika nga sekretaria dhe ekzekutivi, të cilat nuk kanë qenë pjesë e materialit, i kemi pranuar këtu për këtu dhe të gjitha i kemi miratuar. Këto pika janë trajtuar si pika të veçanta të rendit të ditës dhe janë miratuar si në komitet, ashtu e kanë marrë miratimin edhe në Kuvend, po flas për asamblistët e opozitës, konkretisht të PDK-së. Prandaj, nuk është profesional dhe as politike, dhe nuk i shërben askujt që Drejtori i cili vet e ka neglizhuar punën, nuk e ka sjell materialin me kohë, me thënë se asamblistët e PDK-së e kanë kundërshtuar, siç është rasti për pllakën përkujtimore të Driton Veliut, ose tjerat të pavërteta që kanë qarkulluar rreth e për qark me emrin tim, siç është rasti të zjarrfikësit, nëse dikush nuk ka arritur me më kuptuar çka kam thënë lidhur me zjarrfikësit, unë pra e sqaroj dhe të jeni të bindur se kur ky vendim të shqyrtohet nga Ministria e Financave ka me e thënë çështjen e njëjtë. Nëse mjetet janë të dedikuara për zjarrfikësit, atëherë ato duhet të transferohen në kodin e zjarrfikësve dhe në asnjë fjalë timen nuk kam thënë të largohen mjetet për zjarrfikësit. Këtë e kam deklaruar vazhdimisht dhe nuk kam ndryshuar qëndrim. Nuk është në rregull të përhapen të pavërteta apo të krijohen polemika të panevojshme. Shumë mirë që ekziston procesverbali, aty dokumentohet se të gjithë kemi votuar për pllakën përkujtimore të Driton Veliut, përkundrazi që ju keni qenë neglizhent dhe nuk e keni sjellë pikën me kohë. Prandaj le të jemi tolerant, jetojmë në një qytet nuk kemi nevojë me hy në këso polemikash se pastaj edhe unë kam pasur mundësi me e demantuar dhe me thënë që pikërisht ky drejtor nuk e ka sjellë pikën me kohë. Procesverbali është në rregull dhe nuk kam vërejtje, shyqyr që ekziston procesverbali.

Kushtrim Zeneli: Në procesverbalin e mbledhjes së kaluar, mungon në tërësi diskutimi im lidhur me pikën 4) Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026, prandaj të përmirësohet procesverbali.

Kryesuesi i mbledhjes pasi theksoi se diskutimet që janë mbajtur pa mikrofon nuk evidentohen në procesverbal, prandaj vuri në votim procesverbalin nga mbledhja e 4 e KPF-së me vërejtjen e z. Kushtrim Zeneli.

Procesverbali nga mbledhja e katërt e KPF-së u miratua unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportin mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026.

Valon Brahim: Kam një pyetje më tepër të karakterit sqarues, nga pasqyra mujore për vitin 2026 vërehet se në janar kanë qenë 1521 familje përfituese, ndërsa në prill i kemi 1457 familje. Pra, kemi rreth 50-60 familje më pak që përfitojnë asistencë sociale. Do të ishte me interes të dimë nëse kjo rënie është pasojë e punësimit të anëtarëve të këtyre familjeve, a është i rritjes së moshës së fëmijëve që është kriter për përfitim, a mund të na tregoni pse kjo lëvizje gjatë vitit 2026, se nëse 50-60 familje janë punësuar do të isha shumë i lumtur, përndryshe largimi i këtyre familjeve nga asistencë sociale është brengosëse.

Erseka Barani: Unë kam një pyetje lidhur me ndërtimin e strehimores për Qendrën e Strehimit "Raba Voca", deri ku ka arritur procesi dhe pse ende nuk janë zhvendosur viktimat e dhunës në familje në objektin e ri? Gjithashtu, do të doja të dija nga drejtori, nëse ka mundësi, të na japë një informatë se deri ku ka arritur procesi i propozimit tim të paraqitur në mbledhjen e fundit të Kuvendit për mbështetjen financiare në vlerë prej 250 eurosh për viktimat e dhunës në familje.

Ramadan Beshiri: Rënia e numrit të përfituesve të skemave sociale është paraqitur në dy raporte. Raporti i fundit është raport analitik dhe aty sqarohet se kjo rënie nuk ka filluar me ne. Nuk bëhet fjalë për një rënie të menjëhershme, por për një proces gradual që ka filluar në vitin 2023 si rezultat i projektit të SAS-it, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, i cili ka identifikuar familjet që kanë manipuluar me skemat sociale. Bazuar në këto të dhëna dhe në projeksionet lineare, kjo rënie mund të arrijë deri në 47% deri në fund të mandatit, jemi duke u munduar që sa më shumë t'i identifikojmë manipulatorët dhe rastet që vërtetë e meritojnë. Sa i përket Shtëpisë së Sigurt, projekti ka filluar prej kohësh dhe është financuar nga UNMIK-u. Duke pasur parasysh se UNMIK-u financohet kryesisht përmes granteve nga shtetet perëndimore, zhvillimet e fundit gjeopolitike dhe ndërprerja e disa fondeve ndërkombëtare kanë ndikuar që një pjesë e projektit të mbetet e papërfunduar. Këtu përfshihen rrethojat e objektit, inventari i brendshëm, shtëpia ku do të qëndrojnë sigurimi, dhe kamerat e sigurisë, të cilat tashmë janë marrë përsipër të përfundohen nga CBM-i në bashkëpunim me UNMIK-un. Memorandumi është në zyrën ligjore, i cili sapo të jetë gati do të nënshkruhet dhe besoj se shumë shpejtë do të hapet Shtëpia e Sigurt. Sa u përket kërkesave të mia drejtuar Kryetarit, ato kanë qenë të vazhdueshme. Përveç ndihmës që u ofrojmë familjeve me skema sociale, unë i kam paraqitur Kryetarit disa programe konkrete. Njëra prej ideve që synojmë ta realizojmë lidhet me nevojat e tregut të punës, veçanërisht për shoferë kamionësh, dhe kam propozuar që 100 anëtarë të familjeve që janë pjesë e skemave sociale të subvencionohen për marrjen e patentë-shoferit, në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë në tregun e punës. Kjo do të ishte një sukses, sepse ata do të largoheshin nga skemat sociale dhe do të siguronin të ardhura të qëndrueshme për familjet e tyre. Po ashtu, kemi propozuar programe për mësimin e gjuhëve të huaja, duke pasur parasysh kërkesën e madhe në sektorin e shërbimeve telefonike dhe të qendrave të thirrjeve. Synimi është që të mbështeten sa më shumë fëmijët dhe të rinjtë nga familjet me skema sociale, të ftojnë aftësi të reja dhe të edukohen që kjo është një periudhë kalimtare dhe jo të qëndrojnë 10 vite në skema sociale. Gjithashtu, Ligji për skemat sociale ka ndryshuar. Tashmë qytetarëve u dërgohen tri kërkesa për punësim, trajnim profesional apo avancim. Nëse ata nuk u përgjigjen këtyre mundësive, mund të humbasin të drejtën për përfitimin e skemës sociale. Komuna jonë nuk është në vendin e parë për numrin e përfituesve të skemave sociale në raport me numrin e banorëve. Aktualisht, Prishtina dhe Obiliqi kanë përqindje më të lartë. Në renditjen në vendin e tretë, por vazhdojmë të punojmë që numri i familjeve të varura nga skemat sociale të zvogëlohet përmes punësimit dhe fuqizimit ekonomik.

Valon Brahimi: Unë e kam lexuar raportin me kujdes. Në raport thuhet se rënia e numrit të përfituesve nuk është rezultat i hapjes së vendeve të reja të punës nga komuna. Komuna ka përgjegjësi për mirëqenien sociale dhe, po ashtu, në raport theksohet se ende ekziston një nivel i konsiderueshëm i varfërisë dhe i cënueshmërisë sociale. Kur në raport përmendet një nivel i konsiderueshëm i varfërisë dhe cënueshmërisë sociale, atëherë raporti nuk duhet me qenë kontestues. Dhe në fund thotë: Në periudhën e ardhshme mbetet e domosdoshme rritja e investimeve në infrastrukturë sociale, këtu më intereson të di a ka të bëjë me banesat, çka është ndërmarrë deri sot dhe a keni arritur me të identifikuar të gjitha banesat ku janë.

Igballe Islami: Drejtor, ne e dimë rolin e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe rolin e Qendrës për Punë Sociale. Të gjithë e dimë se atje ekziston një drejtor, një staf profesional dhe struktura përgjegjëse që merren me trajtimin e rasteve të skemës sociale, qoftë për pranimin e rasteve të reja, qoftë për largimin e përfituesve nga lista e asistencës sociale, prandaj meritat ose jo për këtë i ka Drejtori i QPS-së. Për këtë arsye, mendoj se nuk është adekuate të përdoren terma si "manipulatorë". Nëse themi se ka pasur manipulime, atëherë në mënyrë të lërtë po akuzohen zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale, sepse pikërisht janë ata që i shqyrtojnë dhe i verifikojnë rastet për të përcaktuar nëse familjet i plotësojnë kushtet për përfitim. Gjithashtu, ju e përmendët se ky është një proces zinxhiror dhe se përgjegjësia nuk bie vetëm mbi Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Pajtohem me këtë, sepse kemi të bëjmë me një sistem ku përfshihen edhe institucionet e tjera, si Zyra e Punësimit, e cila me reformat e reja falë Drejtorit të Zyrës së Punësimit kanë arritur me u menaxhuar edhe rastet e asistencës sociale. Megjithatë përdorimi i termave si "manipulatorë" dhe "familje manipuluese" nuk

më duket i qëlluar. Sa i përket kërkesave të vazhdueshme drejtuar kryetarit, dua të pyes konkretisht: a keni përfutur buxhet shtesë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale? Sepse, sipas informatave që kam, me buxhetin aktual që keni në dispozicion nuk ke mundësi me ju dalë në ndihmë familjeve në nevojë, por ke mjete të mjaftueshme vetëm për me i kryer obligimet ndaj Bashkësisë Islame. Unë besoj se roli i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale nuk është vetëm zbatimi i kontratave apo programeve ekzistuese, po ashtu subvencionimi i familjeve për qira, nuk mund të potencohet si e arritur. Komuna e Mitrovicës disponon me disa banesa, është formuar Komisioni për verifikimin e tyre, prandaj ka shumë faktorë tjerë që mundën me ndikuar drejtpërdrejt në DMS-në që të ketë rezultate e jo pagesa e qirave. Prandaj, pyetja ime mbetet e thjeshtë: a keni siguruar buxhet shtesë dhe, a mendon që ke me pasur mundësi ta implementosh planin e Drejtorisë sate me buxhetin aktual?

Ramadan Beshiri: Raporti është analitik, nuk është politik, ky raport nuk është i imi, është raport i gjendjes sociale në Mitrovicë, por raporti i drejtorit është për periudha të caktuara dhe ju e matni sipas suksesit ose rezultateve. Sa i përket përkrahjes nga Kryetari, ne e kemi përkrahjen e tij mirëpo politikën tona janë të renditura se kur do t'i realizojmë. Për shembull, shumë shpejt do të vazhdojmë me 250 € për viktimat e dhunës, si pjesë e punës së drejtorisë dhe përkrahjes që e ka bërë znj. Erseka Barani. Pyetja që e bëri Valoni, rënia nga lista e asistencës sociale nuk është rezultat i hapjeve të vendeve të punës, nuk mund të hapen vende pune për 4 muaj, ne jemi duke projektuar programe që ju mundëson qytetarëve të dalin nga skemat sociale dhe të jenë vet produktiv. Raporti i skemave sociale ka dalë si rezultat që i ka detektuar edhe sistemi i SAS-it dhe këtë emër e kanë manipulator me skemën sociale. Ne jemi të interesuar t'i identifikojmë familjet që i kanë krijuar kushtet më të mira, si dhe të bëjmë programe që qytetarët të mund dalin nga skemat sociale dhe të mos jemi qyteti më i varfër. Raporti tregon që ka cënueshmëri sociale në Mitrovicë, por ka edhe familje që për shkak të krenarisë nuk vijnë me e kërkuar social, e janë shumë të varfër se disa përfitues. Sa i përket arkitekturës sociale, kemi të bëjmë me objektin për moshën e tretë, arkitekturën sociale në përgjithësi, objektin për fëmijët pa përkujdesje prindërore që kanë përcjellur dhunë, objektin e shtëpisë së sigurt, si dhe pretendimet për me e bërë qendrën autike për fëmijë dhe për persona autik, kjo synon ta plotësojë arkitekturën sociale në tërësi dhe besoj se mund të realizohet shumë gjatë këtij mandati ose në katër vitet e ardhshme.

Valon Brahimiri: Arsyetimi është i mangët, nuk po të tregohen arsyet pse janë larguar nga lista. Nëse vetëm thuhet se nuk i plotësojnë kriteret, nuk është raporti adekuat, duhet të ceken arsyet se cilat kriteret nuk i plotësojnë. Unë mendoj se arsyetimi do të ishte kështu: këto familje janë larguar nga skema sociale për shkak se fëmijët e kanë arritur moshën e caktuar me ligj. Unë e di që raportin e kanë përgatitur stafi juaj, por ata duhet të jenë të kujdesshëm se të thuhet janë larguar 50-60 familje nga skema sociale dhe ka cënueshmëri sociale, kjo nuk shkon. Prandaj kërkoj që raporti të vije më i detajuar për mbledhjen e Kuvendit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 0-abstenime.

Raporti mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportin e punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025.

Visar Sylja: E kam lexuar Raportin, kam një sugjerim për drejtorin, të mos bëhen gabimet që janë bërë më herë, tjanë dy-tri rrugë kryesore të qytetit që nuk janë mirëmbajtur, rruga “Nexhip Dragaj”, rruga “Tërat Dragaj”, nuk pashë mirëmbajtje të këtyre rrugëve, e di që nuk është faji i juaj, prandaj ju sugjeroj që të mirëmbahen edhe këto rrugë.

Valon Brahimiri: Gjatë mandatit tonë kemi pasur një rekomandim nga Stacioni Policor i Jugut, që të largohen disa vazo të vendosura në kohën kur ju z. Muja keni qenë drejtor, sepse kanë ndodhur 2-3 aksidente gati për vdekje. Kam një pyetje: a ka ndonjë analizë prej ekspertëve të fushës se a paraqet

rezikshmëri vendosja e atyre luleve në ishullin “Shemsi Ahmeti”, sepse ishulli është shumë i ngushtë e po ashtu paraqet pengesë edhe për kalimin e mjeteve emergjente, si dhe mundësisht në mbledhjen e radhës me na e sjell pozicionin mbi të cilën është realizuar ajo kontratë, sepse ne vlerësojmë se ka kaluar shifra mbi 10,000 €.

Naser Muja: Jeni duke diskutuar jashtë rendit të ditës. Vendosja e luleve aty më tepër ka të bëjë me vetëdijesim të qytetarëve që të kalojnë nëpër vija të bardha, ndërsa sa i përket kontratave, kur të jetë pikë e rendit të ditës mundemi me diskutuar dhe çka do që të kërkon prej dokumenteve ua dërgojmë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin e punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raporti i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025 u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:46 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI

Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI

